

# DITARI MUJOR MAJ 2026



## ZBULIME TË REJA ARKEOLOGJIKE PASUROJNË HISTORINË E AMANTIAS

Në fillim të muajit, përfunduan gërmimet arkeologjike në Parkun Arkeologjik të Amantias, duke sjellë zbulime të rëndësishme për njohjen e historisë dhe organizimit urbanistik të këtij qyteti antik. Kërkimet e realizuara nga DRTK Vlorë dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore nxorën në dritë një godinë antike në zonën e agorasë, si dhe të dhëna të reja mbi sistemin e fortifikimit të qytetit të poshtëm. Gjetjet dëshmojnë vazhdimësinë e jetës dhe zhvillimit të Amantias nga shekulli III p.Kr. deri në shekullin VI m.Kr., duke pasuruar njohuritë mbi një nga qendrat më të rëndësishme të antikitetit në territorin shqiptar. Kërkimet dhe ndërhyrjet restauruese do të vijojnë edhe në të ardhmen, me synim ruajtjen dhe promovimin e kësaj pasurie të rëndësishme të trashëgimisë kulturore.

## NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E PARË E BASHKËPRODHIMIT KINEMATOGRAFIK MES SHQIPËRISË DHE FRANCËS




U nënshkrua në Cannes të Francës, marrëveshja e parë e bashkëprodhimit kinematografik mes Shqipërisë dhe Francës. Një zhvillim historik për industrinë shqiptare të filmit dhe hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit kulturor ndërkombëtar. Marrëveshja mes Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe CNC-së franceze u krijon kineastëve shqiptarë mundësi të reja për akses në fondet franceze dhe shqiptare, përfitime ligjore e fiskale si filma kombëtarë në të dy vendet, si dhe më tepër akses në tregun evropian dhe bashkëprodhimet ndërkombëtare. Nënshkrimi i saj u shoqërua me takime dhe aktivitete promovuese në Marché du Film, ku u theksua rëndësia e këtij partneriteti për zhvillimin e industrisë kreative shqiptare dhe pozicionimin e Shqipërisë si partner i besueshëm në kinematografinë evropiane.

## SHQIPËRIA HAP PAVIONIN KOMBËTAR ME “A PLACE IN THE SUN” NË BIENALEN E VENECIAS 2026

Shqipëria u prezantua në edicionin e 61-të të Bienales Ndërkombëtare të Artit në Venecia me pavijonin kombëtar “A Place in the Sun” të artistit Genti Korininë një nga skenat më prestigjioze të artit bashkëkohor, si reflektim mbi historinë, kujtesën dhe identitetin. Gjatë aktivitetit u zhvilluan takime me drejtuesit e Bienales së Venecias dhe përfaqësues institucionale nga rajoni, ku u diskutuan mundësitë për zgjerimin e bashkëpunimit kulturor, projektet e përbashkëta në fushën e artit dhe arkitekturës, si dhe forcimi i partneriteteve ndërkombëtare në funksion të zhvillimit të institucioneve kulturore shqiptare. Këto angazhime synojnë të rrisin më tej profilin e Shqipërisë në rrjetet globale të kulturës dhe të krijojnë më shumë mundësi për artistët, kuratorët dhe profesionistët e rinj të fushës.



## FIP PLATINUM ALBANIA 2026 VENDOS SHQIPËRINË NË QENDËR TË PADELIT NDËRKOMBËTAR



FIP Platinum Albania 2026 solli në Tiranë, një nga ngjarjet më të rëndësishme të padelit ndërkombëtar, duke konfirmuar kapacitetet e vendit për organizimin e eventeve sportive të nivelit të lartë. Për pesë ditë me radhë, rreth 20 mijë spektatorë ndoqën nga afër garat ku morën pjesë 150 sportistë nga vende të ndryshme të botës, përfshirë emra të spikatur të renditjes ndërkombëtare. Turneu u mbyll me triumfin e Franco Stupaczuk dhe Mike Yanguas në kategorinë e meshkujve, si dhe të Marina Guinart dhe Veronica Virseda në kategorinë e femrave. Përtej aspektit sportiv, eventit shërbeu edhe për promovimin e Shqipërisë si destinacion turistik dhe sportiv, duke forcuar imazhin e vendit në arenën ndërkombëtare dhe nxitur kështu zhvillimin e turizmit sportiv.



### TURI I 83-TË ÇIKLISTIK I SHQIPËRISË PROMOVON SPORTIN DHE DESTINACIONET TURISTIKE TË VENDIT


Turi i 83-të Çiklistik i Shqipërisë promovoi sportin dhe destinacionet turistike të vendit, duke mbledhur sportistë ndërkombëtarë në një garë që përshkoi disa nga zonat më të bukura të Shqipërisë.

Aktiviteti u mbyll me triumfin e Gabriele De Fabritiis në etapën finale, duke konfirmuar potencialin e vendit për organizimin e eventeve sportive ndërkombëtare dhe zhvillimin e turizmit sportiv.

## RIHAPET MUZEU ETNOGRAFIK I BERATIT, NJË PASURI E ÇMUAR E TRASHËGIMISË KULTURORE SHQIPTARE

Pas një procesi të kujdesshëm restaurimi dhe konservimi, Muzeu Etnografik i Beratit rihapi dyert për vizitorët, duke pasuruar ofertën kulturore dhe turistike të një prej qyteteve më të vizituara të Shqipërisë. Me një koleksion prej rreth 1300 objektsh që pasqyrojnë traditat, zëjet dhe mënyrën e jetesës së beratasve ndër shekuj, muzeu vjen i rikonceptuar për të ofruar një përvojë autentike dhe bashkëkohore. Ndërrhyrjet restauruese kanë ruajtur vlerat monumentale të objektit, ndërsa rimuzealizimi, ndriçimi i ri dhe restaurimi i koleksioneve e kanë shndërruar këtë hapësirë në një qendër të rëndësishme të kujtesës dhe identitetit kulturor. Rihapja e muzeut forcon më tej rolin e Beratit si një destinacion unik të turizmit kulturor, duke krijuar mundësi të reja për promovimin e trashëgimisë, artizanatit dhe edukimit kulturor.





### RRITJE REKORD E VIZITAVE DHE TË ARDHURAVE NË SITET E TRASHËGIMISË KULTURORE

Gjatë periudhës janar-prill 2026, sitet e trashëgimisë kulturore u vizituan nga 219,423 vizitorë vendas dhe të huaj, një rritje prej 114% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, ndërsa të ardhurat u rritën me 142%. Ndër destinacionet më të frekuentuara renditen Kalaja e Gjirokastrës, Parku Arkeologjik i Shkodrës, Parku Kombëtar i Butrintit, Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në Krujë dhe Parku Arkeologjik i Apolonisë.

## INVESTIME PËR RININË DHE SPORTIN NË CËRRIK: MË SHUMË MUNDËSI PËR ZHVILLIM DHE SUKSES



Në Cërrik u inaugurua biblioteka e re “Biblioteka në qytetin tim”, një investim i realizuar me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe në bashkëpunim me Bashkinë Cërrik. Kjo bibliotekë do t’u shërbejë rreth 3,200 të rinjve dhe komunitetit lokal. E konceptuar si një hapësirë moderne për dijen, kulturën dhe përfshirjen sociale, biblioteka ofron ambiente leximi, këndin e digjitalizuar dhe aktivitete kulturore e edukative. Paralelisht, vëmendje iu kushtua edhe sportit si një prioritet i rëndësishëm për zhvillimin e të rinjve, ku Palestra e Shtërmenit u vlerësua si një model suksesi në formimin e kampionëve që kanë përfaqësuar Shqipërinë në arenën ndërkombëtare.

## TEA AWARDS 2026 VLERËSON PROMOTORËT E TURIZMIT DHE EVENTEVE NË SHQIPËRI

Agjencia Kombëtare e Turizmit organizoi për herë të parë TEA Awards 2026, një event i dedikuar vlerësimit të promotorëve të Shqipërisë turistike, bazuar në të dhënat dhe matjet e aplikacionit TEA (Tourism Events of Albania). Çmimet evidentuan aktivitetet, ngjarjet dhe iniciativat që kanë kontribuar në rritjen e vizitueshmërisë, promovimin e destinacioneve dhe forcimin e markës turistike të Shqipërisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Përmes këtij eventi u vlerësuan individë dhe organizata që, me punën dhe vizionin e tyre, kanë ndikuar në zhvillimin e turizmit, kulturës dhe mikpritjes, duke forcuar pozicionimin e Shqipërisë si një destinacion gjithnjë e më autentik dhe tërheqës.



## PËRURUHET MUZEU ARKEOLOGJIK I LEZHËS, NJË HAPËSIRË E RE PËR HISTORINË DHE IDENTITETIN LOKAL



Në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve u inaugurua Muzeu Arkeologjik i Lezhës, një investim i rëndësishëm që pasuron ofertën kulturore dhe turistike të qytetit, duke sjellë më pranë komunitetit dhe vizitorëve historinë e pasur të zonës. Përmes bashkëpunimit mes Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Institutit të Arkeologjisë dhe Bashkisë Lezhë, objektet arkeologjike me vlerë të veçanta historike dhe shkencore janë rikthyer për ekspozim në territorin ku janë zbuluar, duke forcuar lidhjen mes trashëgimisë kulturore dhe identitetit lokal. I financuar nga Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri–Kosovë në kuadër të IPA II të Bashkimit European, projekti kontribuon në zhvillimin kulturor, turistik dhe ekonomik të rajonit, duke krijuar një hapësirë të re kujtese, edukimi dhe krenarie për qytetin e Lezhës.



## UNIVERSITETI I ARTEVE SHËNON 60-VJETORIN SI NJË NGA INSTITUCIONET MË TË RËNDËSISHME TË KULTURËS SHQIPTARE

Në 60-vjetorin e themelimit, Universiteti i Arteve mbledhi studentë, pedagogë, artistë dhe personalitete të kulturës për të kremtuar historinë dhe kontributin e një institucioni që për gjashtë dekada ka formuar breza krijuese dhe ka luajtur rol të rëndësishëm në jetën kulturore e shoqërore të vendit.

Ky jubile vlerësoi jo vetëm arritjet artistike dhe akademike të universitetit, por edhe kontributin e pedagogëve dhe mentorëve që kanë ruajtur dhe përcjellë traditën, pasionin dhe profesionalizmin tek brezat e rinj.

## HANGART ÇEL SEZONIN E RI TË SKENËS SË PAVARUR ARTISTIKE NË TIRANË

HangArt hapi sezonin e ri të aktiviteteve artistike në Kinostudio me performancën “NO-W-HERE”, në kuadër të Javës së Evropës dhe Javëve Kulturore Ndërkombëtare, duke konfirmuar rolin e tij si hapësirë e rëndësishme për artin bashkëkohor dhe skenën e pavarur shqiptare. Përmes interpretimit të artistëve Blenard Azizaj dhe Elena Cattardico, të shoqëruar nga muzika live e Tomor Kuçit, publiku përjetoj performancën e veçantë që ndërthur trupin, tingullin dhe dritën në një reflektim artistik mbi kujtesën, identitetin dhe rezistencën.



## SHQIPËRIA FORCON PROFILIN NDËRKOMBËTAR NË SPORT PËRMES EVENTEVE DHE PARTNERITETEVE STRATEGJIKE



Në vijim të angazhimit për ndërkombëtarizimin e sportit shqiptar, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit zhvilloi takime të rëndësishme me përfaqësues të organizatave sportive ndërkombëtare, duke diskutuar organizimin e eventeve madhore dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal. Në fokus ishte koordinimi për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030, ku Durrësi do të luajë një rol kyç si qytet mbështetës për zhvillimin e sporteve ujore, ndërsa u vlerësua progresi i Shqipërisë dhe bashkëpunimi strategjik mes institucioneve sportive të rajonit. Gjithashtu, gjatë takimit me delegacionin e Federatës Ndërkombëtare të Sportit Shkollor (ISF), u prezantua mundësia e organizimit në Shqipëri të “ISF Gymnasiade 2028”, një nga eventet më të mëdha globale të sportit shkollor, me rreth 5,000 nxënës nga 130 shtete.



### RRITET FLUKSI I TURISTËVE TË HUAJ DREJT SHQIPËRISË

Muaji prill 2026 shënoi një tjetër rezultat pozitiv për sektorin e turizmit, me 891,414 vizitorë të huaj që zgjodhën Shqipërinë, një rritje prej 8.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja më e fortë u regjistrua nga tregje si Lituania, Danimarka, Polonia, Spanja, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërsa interes në rritje vijon të ketë edhe nga Italia, Franca, Belgjika dhe Mbretëria e Bashkuar. Kosova mbetet tregu kryesor për turizmin shqiptar, me mbi 265 mijë vizitorë vetëm gjatë muajit prill.

## INVESTIME NË RIVIERË PËR STANDARDE MË TË LARTA TURISTIKE DHE RIJETËZIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE

Në vijim të përgatitjeve për sezonin turistik, në Jalë, Dhërmi, Himarë dhe Borsh, krahas koordinimit për formalizimin e aktiviteteve përgjatë vijës bregdetare, menaxhimin e stacioneve të plazhit dhe garantimin e standardeve të sigurisë e higjienës, vëmendje e veçantë po i kushtohet projekteve me ndikim afatgjatë. Në Himarë, po përgatitet projekti për mbrojtjen dhe interpretimin e Shpellës së Spilesë, një prej atraksioneve më të veçanta natyrore dhe kulturore të zonës, ndërsa në Borsh vijnë punimet restauruese në kalanë historike, përfshirë konservimin e strukturave, restaurimin e xhamisë dhe përmirësimin e aksesit për vizitorët.



## PREZANTOHET PROJEKTI I RIVITALIZIMIT TË KALASË SË ELBASANIT

Një hap i rëndësishëm drejt transformimit të Kalasë së Elbasanit u shënuar me prezantimin e parë zyrtar të projektit të rivitalizimit, i hartuar nga arkitekti i njohur Emre Arolat dhe MVM Architecture. Projekti synon ta kthejë Kalanë në një destinacion të rëndësishëm kulturor dhe turistik, duke rikthyer në vëmendje identitetin historik, vlerat arkeologjike dhe rolin e saj në jetën e qytetit. Përmes ndërhyrjeve të integruara në hapësirat publike dhe zonën historike, synohet krijimi i një modeli të ri zhvillimi që nxit turizmin, ekonominë lokale dhe jetën kulturore. Pas prezantimit, projekti do të vijojë me fazat e koordinimit institucional dhe procedurat e nevojshme për miratimin dhe zbatimin e tij, në bashkëpunim me institucioneve publike dhe partnerëve zhvillimorë.



## TEDI PAPA VRAMI NDEROHET ME NJË NGA VLERËSIMET MË TË LARTA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në kuadër të Javës Kulturore të Europës, violinisti i mirënjohur ndërkombëtarisht, Tedi Papavrami, u nderua me dekoratën “Ylli i Oficerit të Urdhrit Suprem të Shqiponjës”, akorduar nga Presidenti i Republikës, si vlerësim për kontributin e jashtëzakonshëm në promovimin e kulturës shqiptare në skenat më prestigjioze botërore. Ky vlerësim nderon një artist që prej dekadash ka shërbyer si ambasador i Shqipërisë në kulturën e Evropës, duke e bërë artin shqiptar pjesë të dialogut ndërkombëtar në nivelet më të larta. Ceremonia u pasua me rikthimin e tij në skenën shqiptare me interpretimin e “24 Kapriçiove të Paganinit”, në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, një prej veprave më sfiduese të repertorit botëror për violinë.

